REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr./Br. 50/23
Datë/Datum. 20.04.23
PRISHTINË / PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEËE BODY

---Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (ish-Banka e Ljubljanës) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net

PSH. nr. 50/23

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik (OSHP), në bazë të nenit 105, 106 dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP), në përbërje Vjosa Gradinaj Mexhuani - Kryetare, Agon Ramadani-Anëtar dhe Vedat Poterqoi Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga Operatori Ekonomik (OE) "Albi Company" SH.P.K, me seli në Rahovec, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtim i sallës së edukatës fizike në shkollën fillore" 2 Korriku " në fshatin Loxhë, Pejë-Vazhdim i projektit Ri-tender-II, me numër të prokurimit: 635-22-14380-5-2-1, iniciuar nga Komuna e Pejës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) me 20.04.2023, mori:

V E N D I M

Refuzohet, si e pa bazuar ankesa e OE "Albi Company" sh.p.k, me seli në Rahovec, e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me 23.01.2023, me numër protokolli 50/2023 dhe **vërtetohet** Vendimi i AK i datës 06.01.2023, për dhënie të Kontratës për aktivitetin e prokurimit "Ndërtim i sallës së edukatës fizike në shkollën fillore "2 Korriku" fshati Loxhë" në Pejë – Vazhdim i projektit RITENDER –II" me numër të prokurimit 635-22-14380-5-2-1.

Konfiskohet tarifa për ankesë e OE "Albi Company" SH.P.K. konfom nenit 31 pika 5 të rregullores së punës së OSHP dhe mjetet kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 06.01.2023, Komuna e Pejës, në cilësinë e autoritetit kontraktues ka publikuar vendimin për dhënie të kontratës për aktivitetin e prokurimit "Ndërtim i sallës së edukatës fizike në shkollën fillore "2 Korriku" në fshatin Loxhë, në Pejë – Vazhdim i projektit Ritender –II" me numër të prokurimit 635-22-14380-5-2-1, duke e rekomanduar për kontratë GOE AAG Projekt & Enggroup SH.P.K.

Me 11.01.2023, OE "Albi Company" SH.P.K. ka ushtruar Kërkesë për ri shqyrtimin e vendimit të cituar si më sipër, e cila është refuzuar me vendimin e AK të datës 13.01.2023.

Me 23.01.2023, OE "Albi Company" SH.P.K. ka parashtruar ankesë në OSHP kundër vendimit të cituar si më sipër të AK, e cila është evidentuar me numër të protokollit 50/23.

- Vlerësimi dhe administrimi i provave -

Paraprakisht konstatohet se Autoriteti kontraktues lidhur me ketë aktivitet të prokurimit ka zbatuar procedurë të hapur, punë, vlerë e mesme, kriteri i dhënies së kontratës: tenderi i përgjegjshëm me çmimin më te ulët. Vlera e parashikuar 176,639.50 euro. Në vijim, OSHP ka angazhuar ekspertin shqyrtues të prokurimit që në pajtim nenin 113 të LPP-së, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, i cili në raportin e datës 02 shkurt 2023 ka rekomanduar që:

- Refuzohet si e pa bazuar ankesa e "Albi Company" sh.p.k, me seli në Rahovec
- Të mbetet në fuqi vendimi i AK-së i datës 06.01.2023 *(vendim për dhënie të kontratës)*

Konform nenit 24 paragrafi 1 i Rregullores së Punës së OSHP-së 01/ 2020, e datës 03.03.2022 (amandamentuar), paneli shqyrtues ka vlerësuar se në shkresat e kësaj lënde ka argumente dhe prova të mjaftueshme që vendimi meritor të merret edhe pa dëgjimin e palëve në seancë.

Ankuesi pohon se AK ka rekomanduar për kontratë një OE i cili ne ofertën e tij ka prezantuar stafin profesional mirëpo i njejti nuk përputhet me periudhat e angazhimit sipas referencave të lëshuara nga OE ENG group andaj AK do duhet të vepronte duke ndërmarr ndonjë veprim-verifikim ne ATK ngase sipas nenit 60 të LPP së pari OE fitues duhet të jetë i përgjegjshëm dhe jo me cmim me të lirë ashtu siq eshtë pergjigjur AK në kërkesën pëe rishqyrtim të paraqitur me 11.01.2023.

Ekspertit shqyrtues, sqaron se AK për secilin inxhinier kishte kërkuar përvojën e punës kurse si dëshmi kishte kërkuar kontratën e punës, po ashtu nëse inxhinieri është me kontratë të jetë në listën e pagave në 6 muajt e fundit dhe si dëshmi kishte kërkuar letër referencë ose çfarëdo dokumenti tjetër që dëshmon për përvojën e mëparshme. Pra AK në dosje të tenderit nuk kishte kërkuar që secila përvojë e punës apo referencë e inxhinierëve të dëshmohet me listën e pagave. Paneli shqyrtues konform mendimit të ekspertit shqyrtues dhe sqarimit të tij, vlerëson se ky pretendim ankimor është i paqëndrueshëm

Tutje ankuesi pohon se sipas dokumenteve të dorëzuara në dosjen e tenderit, OE i rekomanduar ka dorëzuar disa referenca me të cilët nuk konfirmohet se ka qenë ndonjëherë menaxher i projektit. Lidhur me ketë eksperti sqaron se sipas dokumenteve të dorëzuara me tender, shihet se në vitin 2009 dhe 2010 *menaxheri i projektit*[1] ishte menaxher i projekteve në kompaninë "N&B Projekt" kurse nga viti 2013 deri në vitin 2016 ishte mbikëqyrës i projektit në kompaninë "Euro Besi" SH.P.K. si dhe sipas referencës shihet se nga vitit 2010 deri në vitin

[1] Emri në shkresa të lëndës

2020 ishte punësuar në kompaninë "Eng Group". Pra lidhur me këtë përvojë, i njëjti ka bashkangjitur diplomën e kualifikimit sipas kërkesës së FDT, referencat sipas kërkesës, kontratën e punës me tani OE të rekomanduar për kontratë dhe i njëjti është në listën e pagave në 6 muajt e fundit ashtu siç është kërkesa e dosjes së tenderit.

Ankuesit me tej pohon se OE i rekomanduar për kontratë AAG Projekt&Enggroup SH.P.K. ka angazhuar për Inxhinier të Ndërtimtarisë drejtimi Hidroteknik (z....)[2] i diplomuar me datën 07/10/2004, i njëjti nuk ka ofruar dëshmi për 6 vite përvojë pune pas diplomimit, me Referenca nga Punëdhënësi, pasi që Referencat e dorëzuar nuk mbulojnë periudhën 6 vite të kërkuar pas diplomimit. Lidhur me ketë ekspertja shqyrtuese në raportin e saj ka sqaruar se për këtë inxhinier, OE i rekomanduar me ofertë ka bashkangjitur diplomën e kualifikimit të datës 07.10.2004, po ashtu referencat e lëshuara nga kompania "Getoari" për vitin 2005 dhe 2006, "Getoari" për vitin 2010, "Eng Group" për vitet 2018 deri 2020, kontratën e punës me kompaninë "Eng Group" të datës 06.01.2020, i njëjti po ashtu figuron në listën e pagave në 6 muaj e fundit të kompania "Eng Group". Andaj si të tillë ketë pretendim e ka cilësuar si të pabazuar.

Ankuesi pretendon se OE i rekomanduar për kontratë për Inxhinierin e makinerisë ka prezantuar (z....)[3] i njëjti nuk ka dëshmuar provojnë e punës minimum 6 vite përvojë, dhe njëherit ka dorëzuar diploma kopje, noterizuar pa ngjyra. Eksperti sqaron në bazë të dokumentacionit të aktivitetit të prokurimit shihet se për inxhinierin e përmendur, OE i rekomanduar me tender kishte prezantuar diplomën e kualifikimit arsimor sipas kërkesës së FDT të lëshuar me datë 31.01.2008, po ashtu reference e lëshuar nga kompania "Alping" për periudhën 01.02.2009 deri me 01.02.2010, nga "ENG Group" për vitet 2010-2020 dhe kontratën e punës të datës 06.01.2020 të lëshuar nga "ENG Group". I njëjti po ashtu figuron në listën e pagave për 6 muajt e fundit, ndërsa sa i përket pikës ankimore se kopjen e diplomës së noterizuar e ka pa ngjyra, kjo është jo relevante.

Sa i përket pretendimit të ankuesit se OE i rekomanduar për kontratë, për Inxhinierin të elektronikes ka prezantuar (z.....)[4] se i njëjti në periudha të ndryshime i angazhuar sipas Referencave të lëshuar nga OE "Eng Group" është e dyshimtë-fiktive dhe kërkon që periudha e angazhimit të verifikohet pranë Administratës Tatimore të Kosovës.

Paneli shqyrtues, krahas mendimit të ekspertit, sqaron në lidhje me çështjen e deklarimit të punëtorëve në ATK, kërkesa e dosjes së tenderit nuk ka qenë që për secilën referencë dhe kontratë të jenë të deklaruar në ATK apo të verifikohen në ATK.

Pra i vetmi kufizim sipas kërkesës së dosjes së tenderit ka qenë që punëtorët të cilët posedojnë kontratë të jenë të deklaruar në ATK në 6 muajt e fundit, ndërsa sa i përket inxhinierit të

[2] Emri në shkresa të lëndës
[3] Emri në shkresa të lëndës
[4] Emri në shkresa të lëndës

elektronikës dëshmohet se është në listën e pagave në 6 muajt e fundit sipas dokumentit të dorëzuar me tender dhe po ashtu posedon kualifikimin arsimor sipas kërkesës së FDT lëshuar me datë 30.09.1999, po ashtu referencën se lëshuar nga "Eng Group" pasi i njëjti është i punësuar nga viti 2006 deri në vitin 2020.

-Përfundim -

Paneli shqyrtues analizoi kërkesën e vendosur në dosje të tenderit nga AK në lidhje me dëshminë dokumentare që ka të bëjë me përvojën e stafit, ku AK ka përcaktuar që për punëtorët të cilët kanë kontrata me operatorin ekonomik duhet të jenë në ATK të deklaruar në listën e pagave në 6 muajt e fundit. Përmes kësaj kërkese nënkuptohet se i vetmi kufizim i deklarimit të stafit që kanë kontratë me operatorin ekonomik duhet të jenë të deklaruar në ATK me dëshmi në listën e pagave në 6 muajt e fundit. Andaj, paneli shqyrtues gjatë shqyrtimit të pretendimeve ankimore nuk mund të vendos jashtë kritereve të përcaktuara në dosje të tenderit, ashtu siç është përcaktuar në nenin 56.3 të LPP-së. Kjo dispozitë ligjore përcakton që tenderuesi nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedura në bazë të ndonjë kërkese ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

Po ashtu, paneli shqyrtues ka shqyrtuar edhe çmimet e tenderëve pjesëmarrës në këtë procedurë të prokurimit, ku OE i rekomanduar për kontratë ka ofertuar me çmim më të lirë se tenderi i OE ankues dhe në këtë kuptim AK ka vendosur në bazë të kriterit "tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët" sipas nenit 60, par.1, nën par. 1.1 të LPP-së.
Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues, deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe administrimit të provave në tërësi, e të gjithë aktivitetit të prokurimit të lartë shënuar, konsideron se gjetjet e ekspertit shqyrtues dhe mendimi i tij janë të pranueshme nga ana e këtij paneli dhe si rrjedhojë paneli vendosi që ankesa të refuzohet si e pabazuar ndërsa të mbetet në fuqi vendimi i autoritetit kontraktues.

Andaj nga të lartcekurat, paneli shqyrtues ne pajtim me nenin 117 të LPP-së vendosi si në dispozitv të këtij vendimi.

Kryetarja e Panelit Shqyrtues
Vjosa Gradinaj Mexhuani

Këshillë Juridike:
Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:
1x1 AK Komuna e Pejës,
1x1 OE "Albi Company" sh.p.k, me seli në Rahovec
1x1 Arkivës së OSHP-së;
1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.